

NJOFTIM PËR INFORMIM NGA KËRKUESI PRANË AGJENCISË KOMBËTARE TË MJEDISIT/AGJENCISË RAJONALE TË MJEDISIT DHE NJQV KU DO TË KETË VENDNDODHJEN INSTALIMI PËR APLIKIM PËR TU PAJISUR ME LEJE MJEDISI TË INSTALIMIT TË TIPIT A OSE B / NDRYSHIME NË FUNKSIONIMIN E INSTALIMIT TË TIPIT A DHE B

Bazuar në Ligjin Nr. 10 431, datë 09.06.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”, të ndryshuar, Ligjin Nr. 10448, datë 14.7.2011 “Për Lejet e Mjedisit” të ndryshuar, Ligjin Nr. 52/2020, datë 30.04.2020 Për disa ndryshime në ligjin nr. 10448, datë 14.7.2011 “Për Lejet e Mjedisit” të ndryshuar dhe VKM nr. 419, datë 25.6.2014 “Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipit A, B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKB-ja” të ndryshuar, Kreu VI “Informimi dhe pjesëmarrja e publikut për aplikimin për leje mjedisi të tipit A dhe B”, pika 2, Njoftimi duhet të përmbajë këto të dhëna:

1. Informacion nëse kërkesa do të jetë për “Aplikim për leje mjedisi të tipit A ose të tipit B” apo “Aplikim për ndryshim thelbësor në kushtet e lejes së mjedisit të tipit A ose të tipit B”; *Aplikim për ndryshimin e kushteve të lejes së mjedisit të tipit B, PN-0970-10-2015*
2. Të dhënat e esktraktit të QKR-së; *Shoqëria “K. I. D – ALB” Sh.p.k, NUIS: K52128506K*
3. Adresën e vendndodhjes së instalimit; *Fshati Metallaj, Metallë, Maminas, Shijak, Durrës.*
4. Përshkrim i veprimtarisë që parashikohet të zhvillohet në instalim; *Industria minerare, ID: 3.7 “Nxjerrja e mineraleve, rërës dhe argjilës nga minierat me shfrytëzim në qiell të hapur dhe nga guroret”, ID: 3.11 “Prodhimi dhe fraksionimi i produkteve minerale jometalike” dhe Menaxhimi i Mbetjeve, ID 5.4 c. “Rikuperim i mbetjeve jo të rrezikshme”*
5. Një përshkrim të elementëve të listuara në formularin informues;
6. Përmbledhjen joteknike të raportit të vlerësimit të ndikimit në mjedis në nivel kombëtar ose ndërkuftar, kur kërkohet procedura e VNM-së në CD;
7. Konsultimet ndërkuftare, kur kërkohet sipas legjislacionit në fuqi; *Nuk ka*
8. Autoritetin vendimarrës për dhënien e aktit të miratimit të lejes së mjedisit, procedurat dhe afatet që do të ndiqen; *Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Mjedisit, afatet janë sipas Kreut III, pika 10 të VKM nr. 419, datë 25.6.2014 e ndryshuar.*
9. Adresën e AKM-së, ku publiku mund të dërgojë komentet dhe sugjerimet e tij, me shkrim apo në formë elektronike, brenda 20 (njëzet) ditëve nga data e njoftimit; info@akm.gov.al

Mbaj përgjegjësi për dorëzimin e njoftimit pranë NJQV-së përkatëse në 20 CD/DVD

Kërkuesi/Përfaqësuesi i shoqërisë

Asllan Baraj

Adresa e-mail

info@kid-alb.al




Adresa

Maminas, Bashkia Shijak, Durrës